KY BULETIN ËSHTË SHTYPUR NË LETËR TË RICIKLUAR

BULETINI MJEDISOR

Numri #2 (shkurt 2011) Abonohu në: www.ks.undp.org

NË KËTË NUMËR

LAJME NGA VENDI

- Familja prodhon rrymë elektrike me mini-hidrocentral
- Riciklimi dhe ngritja e vetëdijes për mjedisin
- Qytei i Shtimes, i pari në Kosovë me ndiçim publik efiçent
- Kursimi i energjisë përmes izolimit
- Me këngë për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës

LAJME NGA REGJIONI

- Raporti për Gjendjen e Mjedisit në Evropë edhe në Gjuhën Shqipe

LAJME NGA BOTA

- Kupa Botërore 2022 e furnizuar nga fermat solare

I nderuari lexues,

Jemi shumë të lumtur që po sjellim tek Ju numrin e dytë të Buletinit Mjedisor. Përshtypjet dhe reagimet pozitive nga ana e lexuesve për numrin e parë të Buletinit, na kanë motivuar që të vazhdojmë me përkushtim edhe më të madh në përgatitjen e këtij numri.

Përderisa në numrin e parë i kemi kushtuar më shumë vëmendje aktiviteteve të nxënësve, shkollave dhe fshatrave për mbrojtjen e mjedisit, kësaj radhe në qendër të vëmendjes kemi vënë përdorimin e burimeve të ripërtrishtme në prodhimin e energjisë dhe rëndësinë e tyre në mbrojtjen e mjedisit dhe në zhvillimin e qëndrueshëm. Në faqet e buletinit do të gjeni edhe informacione për përpjekjet globale, regjionale dhe nacionale për mbrojtjen e mjedisit në forma dhe mënyra të ndryshme të ndërmarra nga institucionet, shoqëria civile dhe nga komuniteti i artistëve. Edhe faktet e rëndësishme mjedisore, këshillat për mbrojtjen e mjedisit dhe kalendari i ngjarjeve mjedisore do të jenë pjesë e informacioneve që e kompletojnë këtë numër.

Duke shpresuar se jemi në rrugë të mirë për të përmbushur synimin tonë për ngritjen e nivelit të informimit cilësorë për mjedisin falënderojmë të gjitha ata që kontribuuan në pasurimin e buletinit me tema interesante dhe me interes për publikun. Ndërsa, përsërisim kërkesën tonë për bashkëpunim dhe inkurajojmë të gjithë individët dhe organizatat e interesuara që të na dërgojnë informacione për aktivitetet e tyre.

Ekipi Redaktues

FAMILJA PRODHON RRYMË ELEKTRIKE ME MINI-HIDROCENTRAL

Në kohën kur Kosova ende përballet me mungesën e energjisë elektrike dhe me reduktime të vazhdueshme të saj sipas planit ABC, diku në një skaj të Kosovës një familje e ka zgjidhur këtë problem në mënyrë të shkëlqyeshme. Është kjo familja Ademi nga fshati Pollatë e cila ka ngritur për nevojat e saj një "minihidrocentral" i cili tash pesë vjet prodhon rrymë vazhdimisht. "Minihidrocentrali" i familjes së Nebih Ademit është i njohur tashmë anë e kënd Kosovës. Punën e nisur nga babai po e vazhdojnë sot krenarë djemtë e tij.

Fshati Pollatë shtrihet rreth 20 km larg Podujevës në veriperëndim të Grykës së Pollatës, aty ku bashkohen lumi me të njëjtin emër, me lumin Llap. Lagjet e fshatit janë të vendosura buzë këtyre lumenjve dhe disa në kodrinat e afërta. Llapjanët thonë se dy nga zbulimet më të rëndësishme të historisë së njerëzimit, rrota dhe rryma, janë bërë bashkë në këtë shekull në një vend malor të Malësisë së Llapit.

Prodhimi i energjisë elektrike nga uji përmes hidrocentraleve të vogla është një prej formave më të mira alternative për të zvogëluar ndikimin në mjedis, për dallim nga prodhimi i energjisë elektrike nga termocentralet. ◊



KY BULETIN ËSHTË SHTYPUR NË LETËR TË RICIKLUAR

BULETINI MJEDISOR

DRITARJA ME INFORMATA TË PËRMBLEDHURA

◊ Cilësia e ajrit në Kosovë është e dobët për shkak të emetimeve nga termocentralet ekzistuese të cilat nuk janë në pajtueshmëri me standardet e tashme të BE-së

◊ Legjislacioni i ri i Kosovës për mjedisin është tërësisht i harmonizuar me standardet e BE-së

◊ Efiçenca e energjisë dhe masat për kërkesë të energjisë janë kritike për të reduktuar normën e lartë vjetore të rritjes së kërkesës për energji në Kosovë

◊ Rreth 150 zona të reja janë në procedurë për mbrojtje ligjore, në mesin e së cilave janë edhe "Bjeshkët e Nemuna" si park nacional

RICIKLIMI DHE NGRITJA E VETËDIJES PËR MJEDISIN

Organizata joqeveritare kosovare "Lulebora" e specializuar në punën me çështjet sociale përfshirë gratë, rininë, fëmijët dhe pakicat, tash udhëheqë me aktivitetin e riciklimit të plastikës. Kjo punë përfshinë grumbullimin, shtypjen dhe shitjen e plastikës PET që zakonisht përdoret në shishet e plastikës dhe në materialin paketues.

Me përkrahje nga Ambasada mbretërore e Holandës, Lulebora ka përfunduar projektin e parë njëvjeçar për mbrojtjen e mjedisit. Projekti filloi me fushatën e vetëdijesimit, dizajnimin dhe shpërndarjen e broshurave informative për mbrojtjen mjedisore dhe riciklim të plastikës. Projekti vazhdoi me punëtori që ndihmojnë angazhimin e komunitetit për mbrojtjen mjedisore. Këto punëtori janë përqëndruar në filozofinë e **reduktimit, ri-shfrytëzimit, riciklimit dhe rishitjes (4R).** Pjesëmarrësit vunë në pah nevojën për një studim të arsyeshmërisë për një program kombëtar të riciklimit dhe nxorrën si konkluzë rëndësinë e avokimit për zbatimin e ligjeve për mbrojtjen e mjedisit dhe legjislacionit sekondar që rregullon nivelet e ndotjes nga bizneset.

Sipas znj. Selvete Gashit, menaxhere e projektit, përvoja e projektit ka vërtetuar mungesën e fushatave mjedisore dhe riciklimit në Kosovë. "Ekziston nevojë urgjente për përgatitjen e programeve që do t'i kontribuojnë edukimit arsimor, në veçanti në mesin e të rinjve", tha znj. Gashi.

Promovimi i rolit të shoqërisë civile në proceset vendimmarrëse dhe bashkëpunimi i shëndoshë në mes të akterëve mjedisor, qeveritar dhe afarist është me rëndësi tepër të madhe për të ardhmen e qëndrueshme të Kosovës. ◊



QYTETI I SHTIMES, I PARI NË KOSOVË ME NDRIÇIM PUBLIK EFIÇENT

Ditë më parë ka përfunduar projekti për renovimin e ndriçimit publik në qytetin e Shtimes, ku me këtë rast është bërë edhe instalimi i sistemeve të prodhimit të energjisë elektrike sipas sistemit foto-voltaik (panela me energji diellore). Në kuadër të këtij projekti është rregulluar sistemi i ndriçimit me panela solare në 53 shtylla elektrike, 38 nga të cilat janë instaluar në shtyllat ekzistuese të ndriçimit publik, ndërsa 15 të tjera në shtyllat e reja që janë ngritur në rrugën Shtime-Ferizaj.

Ideja e projektit për renovimin e ndriçimit publik në qytetin e Shtimes, ka nisur si iniciativë nga Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, me rastin e organizimit të konferencës ndërkombëtare "Mbrojtja e Mjedisit përmes Efiçencës së Energjisë, Praktikat-Mundësitë-Veprimet". Përveç nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, implementimi i projektit është mbështetur edhe nga Komuna e Shtimes dhe nga GTZ-ja. ◊



SI MUND TË NDIHMONI NË MBROJTJEN E MJEDISIT

- Gjithmonë fiki dritat kur del nga dhoma



- Përdor çanta pëlhure në vend të qeseve të plastikës kur bën pazar



- Ndale ujin e rubinetit kur lan dhëmbët



BULETINI MJEDISOR

CALENDARI MJEDISOR

2011-ta, viti ndërkombëtar i pyjeve

2 SHKURTI
Dita botërore e kënetave

21 MARSI
Dita botërore e pylltarisë

22 MARSI
Dita botërore e ujit

23 MARSI
Dita botërore e meteorologjisë

26 MARSI
Ora e tokës

7 PRILLI
Dita botërore e shëndetit

22 PRILLI
Dita e tokës

KURSIMI I ENERGJISË PËRMES IZOLIMIT

Konsumi i energjisë në Kosovë është rritur vazhdimisht gjatë dekadës së fundit. Gjer tani vëmendje relativisht e ulët i është kushtuar masave për kursim të energjisë. Shumicës së ndërtesave në Dragash u mungon izolimi termal apo ndonjë masë tjetër mbrojtëse për kursim të energjisë. Gjatë dimrave të ftohtë, ngrohja e hapësirës zakonisht bëhet me stufa me dru zjarri. Por, mungesa e izolimit shkakton humbje të madhe të nxehtësisë, dhe kjo ngritë çmimin e ngrohjes dhe zvoglon rehatinë brenda ndërtesave.

UNDP-ja zbatoi një projekt testues në Dragash të financuar nga Qeveria e Finlandës për të përkrahur reduktimin e humbjes së energjisë dhe rritjen e efiçencës së energjisë. Nga Drejtoria për arsim dhe Shoqata kosovare për energjinë e ripërtërishme dhe efiçencën e energjisë (AKEREE) u bë analiza e gjendjes së konsumit të energjisë. Si rezultat i saj, shkolla Ulina në fshatin Kosava në Dragash u zgjodh për të përmirësuar efiçencën e energjisë.

Ndërtesa e vjetër e shkollës kishte mure të jashtme pa izolim termal dhe dritare e dyer të vjetra dhe të dëmtuara. Renovimi përfshiu izolimin termal të mureve dhe zëvendësimin e dritareve dhe dyerve të vjetra me të reja. Projekti testues u krye brenda 30 ditëve. Si rezultat i projektit, konsumi i energjisë në ndërtesën e shkollës ra për 36%. Konsumi i druve ra për 35.77% në mes të vitit 2009 dhe 2010, nga 35.84 tonelata në 23.02 tonelata. Përveç kursimit të realizuar të energjisë, ngritja e temperaturës brenda ndërtesës rezultoi në kushte më të këndshme për mësim dhe punë. ◊



ME KËNGË PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS

Pas turneut muzikor nëpër qytetet kryesore të Kosovës, grupi zviceran "Broken Dreams", ka vazhduar me sukses turneun e tyre edhe nëpër disa qytete të Zvicrës. Gjatë koncerteve të mbajtura në Thun, Lozanë, Lucern dhe Cyrih, grupi "Broken Dreams", ka përformuar këngë të cilat janë kompozuar si bashkëpunim i grupit me kompozitorë të njohur nga Kosova. Partiturat e këtyre kompozimeve janë bazuar në njëzet dëshira të fëmijëve kosovarë që pasqyrojnë vizonin e tyre për mjedisin dhe natyrën e Kosovës. Këngët u përformuan në gjuhën shqipe dhe në gjuhën gjermane, ndërsa publiku që ishte i përbërë kryesisht nga diaspora kosovare në Zvicër dhe publiku vendas, adhurues të kulturës dhe muzikës, u ndanë shumë të kënaqur me koncertin.

Grupi Broken Dreams kultivon kryesisht stilin e muzikës "Chanson-Jazz" dhe pjesë e tij janë Alexandra Prusa - vokal, John Wolf Brennan - piano dhe Peter Gossweiler – kontrabas, të ndihmuar edhe nga bateristi kosovar Nesim Maxhuni.

Koncertet janë pjesë e projektit "Kosovambient Song" i cili është mbështetur nga Ambasada e Zvicrës në Kosovë dhe është fryt i një shkëmbimi shumë origjinal kulturor ndërmjet Zvicrës dhe Kosovës. Qëllimi kryesor i këtij projekti është që përmes fëmijëve të përcillet tek të rriturit mesazhi për mbrojtjen e mjedisit. ◊



Grupi zviceran "Broken Dreams"

BULETINI MJEDISOR

RAPORTI PËR GJENDJEN E MJEDISIT NË EVROPË EDHE NË GJUHËN SHQIPE

Agjencioni Evropian i Mjedisit ka publikuar Raportin "Gjendja e Mjedisit në Evropë dhe Perspektiva 2010". E veçantë e këtij Raporti është se një sintezë e tij për herë të parë publikohet edhe në gjuhën shqipe.

Raporti ofron të dhëna për gjendjen e mjedisit në Evropë, duke i kushtuar rëndësi të posaçme ndryshimeve klimatike, biodiversitetit, resurseve natyrore, mbetjeve, shëndetit publik, sfidave mjedisore në kontestin global dhe lidhshmërisë ndërmjet tyre.



Gjendja e Mjedisit në Evropë dhe Perspektiva 2010:
http://www.eea.europa.eu/soer/synthesis/translations/mjedisi-i-evropes-2013-gjendja

Porositë kyçe të raportit përfshijnë:

1. Mundësitë për të reduktuar emetimet e gazit serrë për të plotësuar obligimet e Protokollit të Kyotos
2. Krijimi i rrjetit të gjerë të zonave të mbrojtura dhe programeve për të parandaluar zhdukjen e specieve të rrezikuara
3. Parandalimin e shterjes së vazhdueshme të resurseve natyrore dhe krijimin e mbeturinave që ndërlidhen me rritjen ekonomike
4. Shqetësimet rreth dëmit afatgjatë për shëndetin e njeriut

Raporti trajton në mënyrë të veçantë lidhjen në mes të gjendjes së mjedisit në Evropë dhe megatrendeve të ndryshme globale duke sugjeruar implementimin e politikave mjedisore, forcimin e qeverisjes mjedisore si dhe nevojën e transformimit drejt një ekonomie të gjelbër evropiane e cila do të sigurojë një qëndrueshmëri afatgjate të mjedisit të Evropës. ◊

KUPA BOTËRORE 2022 E FURNIZUAR NGA FERMAT SOLARE

Katari kohëve të fundit ka lansuar një ofertë të suksesshme për të organizuar Kupën Botërore. Kur përfaqësuesit nga komiteti teknik i FIFA-së erdhën për inspektim gjatë muajit shtator, ata u dërguan në një stadium 500 ulësesh dhe me pesë anë të ndërtuar brenda javëve në synim për të dëshmuar se është e mundshme që të luhet futboll në Katar gjatë verës. Rregullat e FIFA-së kërkojnë që ndeshjet e Kupës Botërore të luhen me kulm të hapur. Përgjigjja e Katarit ishte krijimi i një bregu tri metra të lartë të ajrit të freskët ku lojtarët mund të luajnë dhe spektatorët mund të shikojnë.

Burimi i ajrit të freskët mund të gjendet në zemër të shkretëtirës që është në afërsi të stadiumit: një "fermë solare". Në këtë "fermë", celulat fotovoltike lirojnë energjinë gjatë gjithë vitit në rrjetin elektrik nacional dhe gypat e ujit ngrohen gjer në 200 gradë celsius para se energjia të transformohet në pakot e shumta të ngrirjes që qëndrojnë nën stadium. Sipas Lee Hosking, një nga arkitektët nga *Arup Associates*, specialistët Britanik përgjegjës për dizajnimin e kësaj ndërtese që u përmend më sipër, procesi është me zero karbon.
"Sa energji na duhet? E marrim nga dielli". ◊ BBC News

Për numrin e radhës 5/2011, abonohu në: www.ks.undp.org

Versioni online: www.ks.undp.org/?cid=2,26,973

Ky buletin botohet në bashkëpunim mes Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë.

Ekipi redaktues: Afrim Berisha (MMPH), Rizah Hajdari (MMPH), Nadia Chaichee (UNDP) dhe Burbuqe Dobranja (UNDP).

SI MUND TË NDIHMONI NË MBROJTJEN E MJEDISIT

- Mbani Kosovën të pastër për ju dhe fëmijët tuaj



- Eduko dhe puno vullnetarisht për mbrojtjen e natyrës



- Shfrytëzo transportin publik, biçikletën apo ecni në vend të ngasjes së veturës

